



Janar 2026

Të nderuara familje,

Mund të keni parë informacione në media rreth përditësimeve të fundit të rekomandimeve federale për vaksinimin e fëmijëve. Këto përditësime **nuk** ndikojnë në vaksinat që kërkohen për ndjekjen e shkollës në qytetin e Nju-Jorkut. Kërkesat aktuale të vaksinimit, të përcaktuara nga shteti dhe qyteti i Nju-Jorkut, për nxënësit që ndjekin shkollën gjatë vitit shkollor 2025–26, mbeten të pandryshuara.

Në faqen tonë të internetit mund të gjeni informacion në disa gjuhë mbi vaksinat që nxënësit duhet të kenë në fillim të vitit shkollor, si edhe kalendarin e vaksinimit të qytetit të Nju-Jorkut për fëmijët e të gjitha moshave: schools.nyc.gov/immunizations.

Familjet që kanë pyetje lidhur me statusin e vaksinimit të fëmijës së tyre, duhet të kontaktojnë shkollën ose ofruesin e kujdesit shëndetësor.

Sinqerisht,

Kevin Moran

Zëvendëskancelar në Detyrë për Operacionet

Shkollat Publike të Qytetit të Nju Jorkut (New York City Public Schools)